



PROJEKT RAPORT PËR PARTINË POLITIKE PARTIA DEMOKRATIKE PËR VITIN KALENDARIK 2022

I) TË DHËNAT E AUDITUESIT

1.
(Emër, Atësi, Mbiemër)
2. Datëlindja
dd/mm/vvvv
3. Adresa
4. Tel/Cel
5. Email
6. Nr. Vendimi
7. Datë vendimi

I) TË DHËNAT E PARTISË POLITIKE

1. Partia Politike
2. Shkronjat nistore
3. Kryetari
(Emër, Mbiemër)
4. Selia
5. NIPT
6. Financieri
(Emër, Mbiemër)



I. TË DHËNAT E LLOGARARISË BANKARE TË PARTISË POLITIKE

Emri i bankës	1- Union Bank 2- Raiffeisen Bank
Adresa e zyrës së bankës	1- Dega UB, TOPTANI 2- Head office Tirana
Numri i telefonit të zyrës së bankës	Union Bank 04 238 9158 Raiffeisen Bank 00355 4 2381 381
Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	info@unionbank.al info@raiffeisen.al
Numri i llogarisë bankare	1- AL69 2141 1175 0197 5066 5244 0118 2- AL80202110130000000101003045
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar përveprimet tek llogaria bankare	Gazmend Bardhi



A. AKTIVET DHE DETYRIMET

1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve

Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit
Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 31.12.2022 përbëhen:
- Mjetet monetare në arkë dhe në bankë 53,234,104 lekë
Vlera për zërin Mjete Monetare në mënyrë analitike është:

Nr	Llogaritë bankare	Viti Raportues 31.12.2022				Totali në monedhën-Lekë
		LEKE	EURO	USD	CHF	
1	Union Bank në lekë (000203/01)	13,028,247			13,028,247	
2	Union Bank në EURO (000309/01)				-	
3	Union Bank në USD (000202/07)			1,099	117,674	
4	Raiffeisen Bank 0101003045, në lekë	39,434,927			39,434,927	
5	Raiffeisen Bank 0090003045, në lekë	(1,010)			(1,010)	
6	Raiffeisen Bank 8020003045 në EURO		(10)		(1,155)	
7	Raiffeisen Bank 6000003045 në EURO		4,989		569,937	
8	Raiffeisen Bank 8800003045 në EURO				-	
9	Raiffeisen Bank 8030003045 në USD			(10)	(1,082)	
10	Raiffeisen Bank 8010003045 në CHF				745	86,567
Totali i bankave		52,462,164	4,979	1,089	745	53,234,104

- Inventarë dhe shpenzime të parapaguara 120,000 lekë
- Toka, ndërtesa dhe pajisje 23,885,272 lekë
Vlera për zërin Toka, ndërtesa dhe pajisje është i përbërë nga:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Viti Raportues 31.12.2022
1	Ndertime	18,436,509
2	Makineri, linja teknologjike e paisje	5,639
3	Mjete motorike (automjete)	2,722,213
4	Mobilie,orendi, pajisje zyre	2,193,988
5	Programe dhe pajisje informatike	526,925
Totall		23,885,272
Përshkruani vendndodhjen e aktivit Përshkruani vendndodhjen e aktivit - Vendëndodhja e mjeteve monetare është në llogarinë bankare të entitetit - Vendëndodhja e aktiveve materiale është pranë selisë së partisë (Ish SHQUPI).		
Shkruani vlerën e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur - Mjetet monetare në arkë dhe në bankë 53,234,104 lekë - Inventarë dhe shpenzime të parapaguara 120,000 lekë - Toka, ndërtesa dhe pajisje 23,885,272 lekë		
2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve		
Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit Sipas llojit detyrimet në datën e mbylljes së vitit ushtrimor 31.12.2022 përbëhen: - Të pagueshme 7,572,842 lekë		

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet	
Furnitore - Albtelecom	9,661
Furnitore - FSHU	255,566
Furnitore - Vodafone	35,734
Furnitore - GENER 2	1,378,375
Furnitore - UKT,Tiranë	51,314
Furnitore - Dixhiprint AL	133,415
Furnitore - Lajthiza	150,000
Furnitore - Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare	-
Qiradhenes te ndryshem - fushate	90,000
Personeli-pagat	4,217,729
Sig Shoqërore dhe shendetesore	1,251,048
Të tjera detyrime	-
Totali	7,572,842
Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve <i>Vlerat janë si në listën analitike më sipër dhe detyrimet janë bazuar tek faturat e blerjeve</i>	

B. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare	
Periudha e raportimit (data e fillimit dhe e përfundimit të periudhës që mbulon raportin)	01.01.2022 – 31.12.2022
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit	Gjendje arka 01.01.2022 = 0 lekë Gjendje arka 31.12.2022 = 0 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	Të ardhura gjithsej = 105,045,183 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	Shpenzimet gjithsej = 55,271,461 lekë
Bilanci në fund të periudhës së raportimit	Aktive Neto në fund të periudhës = 69,666,534 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	Aktivitet = 77,293,376 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	Detyrimet = 7,572,842 lekë

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse			
	a) bosh/mungon informacioni b) dokumentacioni (shqyrtim ishpejtë)	Po / Jo	Çfarë?
		Të Ardhurat	105,045,183
	- Vendimi i KQZ-së dhe ekstraktet bankar		Të ardhura-Financime publike 104,926,170
	- Donacione		Të ardhura jopublike monetare 4,013
			Të ardhura jopublike në natyrë
	- Ekstraktet bankar, përshkrimi derdhje kuotash		Financim nga burimet e veta të partisë 115,000
			Hua/Kredi
		Shpenzime	55,271,461
	- Faturat sipas sistemit të fiskalizimit		Shpenzime operative të partisë 21,337,514
	- Sipas kontratave dhe faturave		Shpenzime për aktivitete/tubime 1,800,000
			Shpenzime Media/publicitet
	- Sipas listëpagesave të sistemit tatimor		Paga dhe sigurime shoqërore 16,432,263
	- Sipas faturave dhe kontratave		Shpenzime për fushatë 15,701,684

b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarinimin e aktiveve dhe detyrimeve.
Gjatë auditimit nuk u has asnjë parregullsi
- Defiçit/ shpenzime të papaguara
Në shpenzimet e papaguara bëjnë pjesë faturat e papaguara për listën si në vijim:

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2022
1	Furnitore per mallra e sherbime	
	Furnitore - Altelecom	9,661
	Furnitore - FSHU	255,566
	Furnitore - Vodafone	35,734
	Furnitore - GENER 2	1,378,375
	Furnitore - UKT,Tiranë	51,314
	Furnitore - Dixhiprint AL	133,415
	Furnitore - Lajthiza	150,000
	Furnitore - Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare	-
	Qiradhenes te ndryshem - fushate	90,000
2	Personeli-pagat	4,217,729
3	Sig Shoqërore dhe shendetesore	1,251,048
4	Të tjera detyrime	-
	Totali	7,572,842

II. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit vjetor	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit si ndihmë financiare vjetore	104,926,170	104,926,170
	Data e marrjes së fondit 03.03.2022	03/03/2022 = 80,000,000 lekë 03/03/2022 = 24,926,170 lekë	03/03/2022 = 80,000,000 lekë 03/03/2022 = 24,926,170 lekë
	Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit si paradhënie për fushatë zgjedhore		
	Data e marrjes së fondit		
2/ Të ardhura jopublike monetare/në natyrë			

MERI LIKA

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modell KQZ-03-01

	Shuma e përgjithshme e raportuar	4,013	4,013
	Shuma e dhurimeve në para	4,013	4,013
	Shuma e dhurimeve në natyrë		
	Paraqitja e një liste të dhuruesve		
	Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare		
	Përputhshmëria mes çdo dhurimi të raportuar dhe deklaramit bankar (shuma)	Shuma përputhet	4,013
	Përputhshmëria mes çdo dhurimi të raportuar dhe deklaramit bankar (data)	24/02/2022 Data përputhet	24/02/2022
	Përputhshmëria mes çdo dhurimi të raportuar dhe deklaramit bankar (donatori)		
	Përputhshmëria mes çdo dhurimi në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (dhuruesi / data)		
	A përputhen shifrat e përgjithshme?		
	Respektimi i kufirit të dhurimeve		
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
	Kuotat e anëtarësisë	115,000	115,000
	Botimet		
	Shtypshkronja		
	Dhënia me qira		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
	Kuotat e anëtarësisë		
	Botimet		
	Shtypshkronja		
	Dhënia me qira		

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modell KQZ-03-01

Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma) <i>Të gjitha shumat përputhen me shumat e depozituara sipas statement bankar</i>	05/01/2022	5,000	05/01/2022 5,000 05/01/2022 60,000 07/02/2022 5,000 07/03/2022 5,000 05/04/2022 5,000 05/05/2022 5,000 06/06/2022 5,000 05/07/2022 5,000 05/08/2022 5,000 07/09/2022 5,000 05/10/2022 5,000 07/11/2022 5,000
	05/01/2022	60,000	
	07/02/2022	5,000	
	07/03/2022	5,000	
	05/04/2022	5,000	
	05/05/2022	5,000	
	06/06/2022	5,000	
	05/07/2022	5,000	
	05/08/2022	5,000	
	07/09/2022	5,000	
	05/10/2022	5,000	
	07/11/2022	5,000	
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (data) <i>Të gjitha datat përputhen me shumat e depozituara sipas statement bankar</i>			
4/ Huatë/Kreditë			
Shuma e përgjithshme e raportuar			
Shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)			
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)			
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi/hua)			
5/ Marrja e të ardhurave			
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	Po	Po	

Kontributet e Specifikuara

Kriteret e kontributeve	
	Emri i kontribuesit
	Adresa e kontribuesit
	Profesioni i kontribuesit (nëse kontribuesit nuk ka profesion, shkruani "nuk ka profesion")

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



	Përshkrimi i kontributit (i tillë si “para në dorë” apo “çek” apo “transfertë bankare” apo “përshkrimi i kontributit nënatyrë”)
	Vlera e kontributit (për kontributet në natyrë shkruani vlerën e tregut, që është vlera e sendit nëse shitet në atë gjendjeaktuale)
	Data kur është marrë kontributi

B. ANALIZA

a/ Financimi nga burimet jo publike

Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;

Neni 21 i Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000, ndryshuar më Ligjin Nr. 10374, datë 10.02.2011, Ligjin Nr. 17/2014, datë 20.02.2014, Ligjin Nr 25/2014, datë 25.09.2014, përcakton se “Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privat vendas” sikurse Neni 23/1 (ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011) vë në dukje se:

1. Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.
2. Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Personi përgjegjës për financat në partinë politike, brenda tre muajve nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.
4. Kategoritë e subjekteve që ndalohen për të financuar fushatën zgjedhore janë:
 - individë apo kompani që kanë përfituar fonde publike në 3 vitet e fundit me vlera mbi 10 milion leke nga kontrata publike apo koncesione ;
 - individë apo kompani të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e medias;



- individë apo kompani që kanë qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
 - individë apo kompani që kanë detyrime monetare ndaj buxhetit të shtetit apo çdo institucioni publik.
5. Ndalohet financimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore nga individë apo kompani të huaja.
6. Vlera maksimale e dhurimit për fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 1 milionë lekë nga i njëjti dhurues për subjektet zgjedhore përfshirë edhe kandidatët e tij.

Këtyre kërkesave ligjore subjekti Partia Demokratike i është përmbajtur dhe i ka respektuar në mënyrë rigorozë. Ka vetëm një financim jo publik në shumën 4,013 lekë si dhe ky donacion është plotësisht i evidentuar.

- **Donatorët e lejuar:**

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
U kontrollua identiteti i donatorëve dhe nuk tejkalohe kufijtë ligjorë.
- o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivelqendror dhe nga një degë e partisë;
U kontrollua shuma dhe i vetmi donacion është në shumën 4,013 lekë, pra nuk tejkalon kufizimet ligjore.
- o Të paraqitet një listë e të gjithë donatorëve shuma e përgjithshme e të cilëve është më e madhe se 100,000 Lekë në raportin vjetor, së bashku me shumën e përgjithshme të dhuruar;
Nuk ka donatorë në shuma më të mëdha se 100,000 lekë
- o Të paraqitet shuma e donacioneve që kanë vlerën më pak se 100.000 Lekë, dhe shuma totale e këtyre donacioneve;
Donacionet që e kanë vlerën më pak se 100.000 lekë janë: datë 24/02/2022 shuma 4,013 lekë

- **Burimet e palejuara**

Nuk ka donacione nga burime të palejuara

- **Kontributet në natyrë**

- o Vlerësimi:

Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) financimit dhe veprimtarisë vullnetare

Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave / shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë) → kur partisë i ofrohen mallra apo shërbime falas në një çmim që është 10% më i ulët se çmimi i tregut, dallimi mesçmimit të tregut dhe pagesës së paguar nga partia duhet të pasqyrohet si donacion (së bashku me emrat e donatorëve nëse ky dallim



e kalon shumën 100,000 Lekë).

Çmimi i tregut të mallrave dhe shërbimeve duhet të përcaktohet nga referenca e indeksit të çmimeve mujore të botuar nga INSTAT në kohën kur janë dhënë/ofruar mallrat/shërbimet. Në rast se indeksi nuk përfshin mallrat/shërbimet e ofruara, partia politike duhet të llogarisë çmimin e tregut duke u bazuar në mesataren e çmimeve të tre ofruesve të ndryshëm të mallrave/shërbimeve në kohën kur ato janë ofruar.

Nuk ka kontribute në natyrë

o Kufizimet

Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;

Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë).

Nuk tejkalohe kufizimet

b/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe ndarja e shumave të marra = 115,000 lekë sipas datave dhe shumave këto të ardhura janë:

o

Data	Shuma	Data	Shuma
05/01/2022	5,000	05/07/2022	5,000
05/01/2022	60,000	05/08/2022	5,000
07/02/2022	5,000	07/09/2022	5,000
07/03/2022	5,000	05/10/2022	5,000
05/04/2022	5,000	07/11/2022	5,000
05/05/2022	5,000	TOTALI	115,000
06/06/2022	5,000		

MERI LIKA

(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



- o Botimet
- o Shtypshkronjat
- o Marrja me qira.....
- **Klasifikimi në bazë të emrit të degës i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar**
 - o Zyra Qendrore = 115,000 lekë
Kjo shumë përfaqëson të ardhurat nga kuotat e antarësisë, të gjitha këto fonde janë të depozituara në llogarinë bankare të subjektit.
 - o Degët lokale
- **Përputhshmëria mes natyrës së të ardhurave dhe shumës së deklaruar dhe deklarimit bankar**

Të ardhurat e raportuara në pasqyrat financiare për vitin ushtrikor 2022 janë plotësisht të përputhura me natyrën e tyre, me raportimin financiar vjetor të hartuar nga PD dhe me deklarimet bankare.

c/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve *Nuk ka hua*
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë). *Nuk ka hua*
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë/huasë/ve (problemi i huave të fshira– në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet) *Nuk ka hua*
- Normat e interesit *Nuk ka hua*

MERI LIKA

(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



III. SHPENZIMET

A.PËRMBLEDHJE

Shpenzimet e bëra nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzime të deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumentet mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzimet operative të partisë							
- Shpenzime për ambiente	14,319,522	14,319,522					14,319,522
- Shpenzime ngazyrat rajonale							
- Shpenzime energjie	2,786,590	2,246,404		540,186	255,566		2,246,404
- Shpenzime ujësjellës	23,196	23,196			51,313		23,196
- Shpenzime telefonie/interneti	475,030	475,030			87,047		475,030
- Transporti							
- Shpenzime për materiale							
- Shpenzime për dokumenta							
- Shërbime bankare	52,568	52,568					52,568
- Shpenzime për dhurata							
- Shpenzime taksa	15,000	15,000					15,000
- Shërbime të tjera							
- Shpenzime pagesë gjobe	192,840	192,840					192,840
- Shpenzime pagesë interesi në rast kredie							
- Amortizimi	2,332,532	2,332,532					2,332,532
- Shpenzime zyre	663,320	663,320					663,320

MERI LIKA
(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- Shpenzime administrative	476,916	476,196					476,196
Shpenzime për aktivitete/ tubime							
- Shpenzime për tubime gjatë vitit	1,800,000	1,800,000					1,800,000
- Shpenzime për kongresin e partisë							
- Shpenzime për forumin e gruas							
- Shpenzime për zgjedhjet e brendshme							
- Shpenzime për aktivitete/shërbime							
Shpenzime mediapublicitet							
- Shpenzime media							
- Shpenzime për abonime në shtyp							
Paga dhe sigurimet shoqërore							
- Shpenzime për pagat e personelit	14,142,295				4,217,729		14,142,295
- Shpenzime sigurime shoq dhe shëndet	2,289,968				1,251,048		2,289,968
Shpenzime për fushatë	15,701,684	15,701,684					15,701,684
Të gjitha shpenzimet e kryera të paguara përmes një llogarie të veçantë						Po / Jo	PO

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



A. ANALIZA

a/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë:

- Shpenzimet e qiramarrjes

- ☐ Marrja me qira e ambienteve *Nuk ka*
- ☐ Shërbimet komunale (energji, uji, telefoni)

Të gjitha shpenzimet janë shpenzimet e degës qendrore dhe janë të specifikuar si vijon:

- Energji = 2.786.590 lekë
- Ujë = 23.196 lekë
- Telefon = 475.030 lekë

Të gjitha shpenzimet janë të mbështetura në fatura të fiskalizuara me përjashtim të shumës 540.186 lekë shpenzime energjie të cilat janë dy kontabilizime të transfertave bankare dhe jo të faturave.

Këto shpenzime janë të kontrolluara të gjitha nga audituesi si dhe përputhja e tyre me kontabilitetin.

- Stafi/ rrogat

Bazuar mbi listëpagesat e deklaruar në sistemin tatimor shpenzimet e deklaruar për paga dhe sigurime shoqërore përputhen me to. Ne kemi hartuar përmbledhësen e tyre nisur nga listapagesa dhe e kemi kontrolluar me kontabilizmin e tyre. Të dhënat për këto dy shpenzime janë si në tabelën në vijim:

Partia Demokratike 2022	Nr të punësuar	Paga bruto		Kontribute per sigurimet shoqerore			20) Kontribute per sigurimet shendetesore gjithsej ne leke	21) Gjithsej Kontribute (19+20)	23) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke	
		14) Gjithsej	15) Mbi te cilen llogariten kontributet	Nga keto:		19) Gjithsej = (13+14+15)				
				16) Punedhenes	17) Punemaresi					
1	Janar	25	1,484,176	1,444,938	215,846	137,170	353,016	50,463	403,479	95,443
2	Shkurt	25	1,484,176	1,444,938	215,846	137,170	353,016	50,463	403,479	95,443
3	Mars	25	1,500,176	1,460,938	218,246	138,690	356,936	51,007	407,943	97,523
4	Prill	23	1,449,189	1,409,951	209,302	133,702	343,004	49,273	392,277	93,885
5	Maj	23	1,449,189	1,409,951	209,302	133,702	343,004	49,273	392,277	93,885

MERI LIKA

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

6	Qershor	23	1,449,189	1,409,951	209,302	133,702	343,004	49,273	392,277	93,885
7	Korrik	16	905,700	884,080	131,317	83,844	215,161	30,794	245,955	51,636
8	Gusht	16	905,700	884,080	131,317	83,844	215,161	30,794	245,955	51,636
9	Shtator	16	912,700	891,080	132,367	84,509	216,876	31,032	247,908	51,636
10	Tetor	16	912,700	891,080	132,367	84,509	216,876	31,032	247,908	51,636
11	Nentor	14	844,700	823,080	122,167	78,049	200,216	28,720	228,936	51,636
12	Dhjetor	14	844,700	823,080	122,167	78,049	200,216	28,720	228,936	51,636
	Totali		14,142,295	13,777,147	2,049,546	1,306,940	3,356,486	480,844	3,837,330	879,880

- **Media**

- **Komunikimi**

- Botime
- Materiale promovuese

Gjatë vitit 2022 janë kryer shpenzime fushate në shumën 15.701.684 lekë të cilat përfshijnë:

Aktivite fushate, printime materiale promovuese, organizim aktivitetesh etj.

Gjatë kontrollit u vu re se për këto shërbime nuk janë kontabilizuar faturat, por shpenzimi është kontabilizuar në momentin e kryerjes se pagesës. Në lidhje me to nga subjekti na janë paraqitur, kontratat për kryerjen e shërbimit si dhe faturat përkatëse. Këto shpenzime përfshijnë:

NR FATURE	DATA	FURNITORI	PERSHKRIMI I SHERBIMIT NE FATURE	SHUMA	KONTROLLUAR NGA AUDITORI
34	07/03/2022	ASLV SHPK fature	Shërbim Takime Hapje dhe mbyllëse	1,800,000	✓
382	07/03/2022	Dixhi print	Aktivite fushate në kuadër të fushatës së zgjedhjeve lokale të pjesshme '22	2,215,662	✓
380	07/03/2022	Dixhi print	Punime për fushatën e zgjedhjeve lokale të pjesshme 2022	7,384,603	✓
2	09/03/2022	Martin Huta	Organizim aktivitetesh	2,500,825	✓
100	09/03/2022	My Afisha	Materiale promovuese (kap,bluz,byrz gome me logo)	1,800,594	✓
TOTALI				15,701,684	

- Sondazhe të opinionit publik / konsulenca

- **Transporti**

MERI LIKA

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



- Marrja me qira e automjeteve dhe karburanti
- Akomodimi
- Vaktet dhe shpenzimet e paparashikuara

- **Shpenzimet bankare**

Shpenzimet bankare janë të gjitha të evidentura në ekstraktet bankare dhe janë në shumën 52.568 lekë.

- **Administrative dhe të përgjithshme**

- **Amortizimi**

Kam kontrolluar gjendjen fillestare të Aktiveve Afatgjata, kam llogaritur amortizimin për vitin 2022 dhe kam kontrolluar gjendjen në datën 31.12.2022 që ka dalë në pasqyrat financiare. Llogaritjet janë të kryera në rregull dhe amortizimi, bazuar në kontrollin e kryer, është si në tabelën në vijim:

LLOJI I AKTIVIT	Kontabiliteti	%	Amortizimi 2022	Aktivet Neto 31.12.2022	Kontrolluar nga auditori
NDERTESA	19,406,851	5%	970,343	18,436,508	✓
MAKINERI DHE PAJISJE	7,047	20%	1,409	5,638	✓
MJETE TRANSPORTI	3,402,765	20%	680,553	2,722,212	✓
MOBILJE DHE PAJISJE ZYRE	2,742,485	20%	548,497	2,193,988	✓
PAJISJE INFORMATIKE	658,655	20%	131,731	526,924	✓
TOTALI	26,217,803		2,332,533	23,885,270	✓

- **Menaxhimi i pronës**

Gjatë vitit 2022 bazuar në dokumentacionin e administruar nga subjekti politik janë kryer punime në ndërtesë në shumën 14.319.522 lekë.

Në kontroll u vu re se për këto shërbime nuk janë kontabilizuar faturat, por shpenzimi është kontabilizuar në momentin e kryerjes së pagesës. Në lidhje me to nga subjekti na janë paraqitur, kontratat për kryerjen e shërbimit si dhe faturat përkatëse. Këto shpenzime përfshijnë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

NR FATURE	DATA	FURNITORI	PERSHKRIMI I SHERBIMIT NE FATURE	SHUMA	KONTROLLUAR NGA AUDITORI
381	07/03/2022	DIXHI PRINT-AL	Punime dhe restaurime ne seline e Partise Demokratike	5,169,362	✓
4	08/03/2022	Aurora shpk	Materiale Ndertimi per riparim dhe punime ne ambientet e selise qendrore	9,150,160	✓
TOTALI				14,319,522	

- **Shpenzime të tjera**

Shpenzime të tjera të kryera nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë përfshijnë zëra si:

SHPENZIMI	SHUMA	KONTROLLUAR NGA AUDITORI
Tubime gjatë vitit	1,800,000	✓
Taksa dhe tarifa vendore	15,000	✓
Shpenzime pastrimi	501,520	✓
Të ndryshme	85,000	✓
Reklama FB dhe blerje online etj	428,074	✓
Diferenca kursi	48,841	✓
Gjoba penalitete	192,840	✓
TOTALI	3,071,275	

b/ Verifikimi

- **Rrisqet**

Duke qenë se subjekti politik është subjekti i dytë për nga përdorimin i fondeve publike Rreziku fillestar i vlerësuar i lartë.

- **Rrisqet kryesore të auditimit në lidhje me shpenzimet e partisë janë se:**

- Shpenzimet deklarohen më të ulëta

MERI LIKA

(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

27/11/2023

(data dd/mm/vvvv)



Për subjektin Partia Demokratike u kontrolluan të gjitha faturat për shpenzimet e paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit 2022 dhe nuk u hasën deklarime më të ulta. (Kontrolluar të gjitha faturat)

- Shpenzimet nuk shoqërohen nga një faturë e vërtetë
Të gjitha shpenzimet janë të shoqëruara me fatura, të cilat janë qenë të fiskalizuara ose fatura online në rastet e shpenzimeve të kryera në platformat online.
- Informacioni për shpenzimet e partisë përfshin jo vetëm aktivitetet e përditshme të partisë por gjithashtu edhe shpenzimet që kanë të bëjnë me një fushatë zgjedhore në vitet zgjedhore.
Gjatë vitit 2022 subjekti politik Partia Demokratike ka kryer shpenzime për fushatën e Zgjedhjeve Vendore pjesore në shumën 13.484.203 lekë (sipas raportimit financiar të fushatës zgjedhore për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore).
Gjatë auditimit, bazuar në faturat e kontrolluara shpenzimet për fushatën janë vlerësuar në shumën 15.701.684 lekë. (shpjeguar në mënyrë analitike në pikën – Komunikimi, Materiale promovuese).

- Në mënyrë që të dokumentohen mirë financat e partisë politike nevojitet përdorimi i metodave standarde të auditimit. Në kontekstin e financave të partisë politike, metodat e mëposhtme janë shembuj i hartimit të metodave të tilla për specifikat e financave të partive politike:

- Shqyrtoni një kategori të deklaruar të përzgjedhur të pagesave (për shembull për komunikimet) të krahasuar me dokumentacionin mbështetës/evidencat (faturat);
Në lidhje me dokumentimin sa më të mirë, kam kontrolluar të gjitha kategoritë e veçanta të shpenzimeve të cilat janë shpjeguar në mënyrë analitike në zërat përkatës të shpenzimeve. Në lidhje me këtë pikë kam kontrolluar çdo shpenzim me faturën përkatëse, kontratën (në rastet kur ka patur), kontabilizimin e tyre si dhe likuidimin e detyrimit.
Duke qenë se shpenzimet e utiliteteve nuk i kam paraqitur në mënyrë analitike në këtë raport, po paraqes në këtë seksion shpenzimet për energji elektrike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

KONTABILITETI I SUBJEKTIT					KONTROLLI I AUDITORIT		
Lloji i dokumentit	Nr dokumenti	Data	Pagesa	Faturat	Kontrolli i faturës dhe ekstraktit bankar	Diferenca	Kontrolluar nga auditori
Gjendja	Celja	01/01/2022		732,494	732,494	0	✓
Fat blerje	429693972	31/01/2022		427,778	427,778	0	✓
Fat blerje	429485309	31/01/2022		340	340	0	✓
Fat blerje	430927759	28/02/2022		312,614	312,614	0	✓
Fat blerje	430918123	28/02/2022		340	340	0	✓
Transferte	37318	03/03/2022		59,085	0	59,085	Ka vetëm transfertë
Transferte	3/3/3	03/03/2022		481,101	0	481,101	Ka vetëm transfertë
Transferte	3/3/7	03/03/2022	427,778		-427,778	0	✓
Transferte	3/3/6	03/03/2022	340		-340	0	✓
Fat blerje	432078164	31/03/2022		331,312	331,312	0	✓
Fat blerje	432366033	31/03/2022		340	340	0	✓
Fat blerje	434767418	31/05/2022		209,462	209,462	0	✓
Fat blerje	434967092	31/05/2022		340	340	0	✓
Transferte	20/6/6	20/06/2022	55,840		-55,840	0	✓
Transferte	20/6/11	20/06/2022	340		-340	0	✓
Transferte	20/6/10	20/06/2022	173,677		-173,677	0	✓
Transferte	20/6/9	20/06/2022	158,540		-158,540	0	✓
Transferte	20/6/8	20/06/2022	340		-340	0	✓
Transferte	20/6/7	20/06/2022	238,492		-238,492	0	✓
Transferte	20/6/5	20/06/2022	312,614		-312,614	0	✓
Transferte	20/6/4	20/06/2022	340		-340	0	✓
Transferte	20/6/2	20/06/2022	331,312		-331,312	0	✓
Fat blerje	436278488	30/06/2022		277,653	277,653	0	✓
Fat blerje	436278265	30/06/2022		340	340	0	✓
Transferte	7/7/0	07/07/2022	340		-340	0	✓

MERI LIKA
(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Modeli KQZ-03-01

Transferte	7/7/2	07/07/2022	209,462		-209,462	0	✓
Fat blerje	437417622	31/07/2022		255,662	255,662	0	✓
Fat blerje	437605746	31/07/2022		340	340	0	✓
Transferte	2/8/0	02/08/2022	340		-340	0	✓
Transferte	2/8/1	02/08/2022	277,653		-277,653	0	✓
Transferte	2/8/2	02/08/2022	279,921		-279,921	0	✓
Fat blerje	438773985	31/08/2022		229,874	229,874	0	✓
Fat blerje	438871217	31/08/2022		340	340	0	✓
Transferte	12/9	12/09/2022	255,665		-255,665	0	✓
Transferte	12/9/0	12/09/2022	340		-340	0	✓
Fat blerje	440117384	30/09/2022		199,331	199,331	0	✓
Fat blerje	439754910	30/09/2022		340	340	0	✓
SALDO NË FUND					255,566	540,186	

- Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ketë një përputhje me donacionet në natyrë.
Subjekti politik Partia Demokratike nuk ka shpenzime në natyrë.

MERI LIKA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

27/11/2023
(data dd/mm/vvvv)

V. PËRFUNDIMI

A . SINTEZA

a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

- Pasqyrat financiare të subjektit Partia Demokratike janë përgatitur bazuar në SKK për OJF-të i shpallur nga Ministria e Financave me Urdhër Nr. 62 datë 17.05.2016.
- Këto pasqyra e realizojnë objektivin e pasqyrave financiare për dhënien e një informacioni rreth pozicionit financiar, pasqyrës së aktiviteteve si dhe për fluksin e mjeteve monetare për vitin ushtrimor 2022.
- Pasqyra financiare japin një pamje të drejtë rreth aktiviteteve të subjektit me përjashtim të parregullive që janë theksuar në pikën b.
Të dhënat e periudhave të mëparshme janë të krahasueshme me të dhënat e periudhës së vitit ushtrimor 2022.
- Për vitin 2022 subjekti nuk ka bërë vlerësime kontabël me ndikim material.
- Subjekti Partia Demokratike, nuk ka kontribute të marra në natyrë. Ajo ka vetëm një donacion nga një person fizik shtetas shqipëtar në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr 10019 datë 29.12.2008 i ndryshuar “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” si dhe të Ligjit Nr 8580 datë 17.02.2000 i ndryshuar “Për partitë politike”.
- Të ardhurat janë dokumentuar dhe regjistruar sipas rregullave kontabël. Në të ardhurat janë përfshirë edhe donacionet.
- Në shpenzime janë përfshirë shpenzimet e bëra gjatë vitit ushtrimor 2022.
- Gjate vitit 2022 subjekti ka kryer shpenzime për fushatë zgjedhore.

b. Lista e parregullive të gjetura gjatë procesit të auditimit.

Gjatë procesit të auditimit janë gjetur parregullsitë si vijon:

- Shpenzimet e zërit shpenzime të tjera nuk janë kontabilizuar sipas parimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kudri i Përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare’, të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraaja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.
Kjo parrëgjulsi është hasur edhe në llogarinë e shpenzimeve për blerje energjie.
- Në shpenzimet e paraqitura si shpenzime për fushatën elektorale, ka një diferencë prej 2.215.662 lekë të cilat nuk janë



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Modeli KQZ-03-07

përfshirë në shpenzime fushte por janë paraqitur si shpenzime normale të subjektit, ndërkohë që përshkrimi në faturë cilësohet si shpenzime për fushatën elektorale.

- Në pasqyra financiare subjekti nuk ka paraqitur të ardhura dhe shpenzime për degët e saj.
- Nisur nga fakti se viti 2022 ka patur zgjedhje pjesore, në pasqyrat financiare nuk janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve.

B. PËRFUNDIMI

o Çertifikimi me përmirësime / rezerva

Të nderuar zotërinjë,

Ne kemi audituar fondet e përfuara dhe të shpenzuara për vitin 2022, nga subjekti “Partia Demokratike”, të raportuara prej saj sipas kërkesave të ligjit nr 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, të hartuara në përputhje me ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht me Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të) dhe të publikuara në faqen e KQZ-së, që përmbajnë:

1. Pasqyrën e pozicionit financiar
2. Pasqyrën e aktiviteteve
3. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare
4. Shënimet shpjeguese

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin “Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit”, pasqyrat financiare, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).